

VENDIM
Nr. 123, datë 16.8.2017

**MBI KËRKESËN E KOMPANISË “KESH” SHA PËR ZGJIDHJEN E
MOSMARRËVESHJES NDËRMJET “KESH” SHA DHE “OST” SHA, LIDHUR ME
PËRMBUSHJEN E DETYRIMIT TË SHËRBIMIT PUBLIK QË RRJEDH NGA
VENDIMI I ERE-S NR. 194, DATË 30.12.2016, “PËR MIRATIMIN E KËRKESËS SË
SHOQËRISË OST SHA, LIDHUR ME MBULIMIN E HUMBJEVE NË RRJETIN E
TRANSMETIMIT, SHËRBIMET NDIHMËSE DHE DISBALANCAT”**

Në mbështetje të neneve 16 dhe 20, germa “a” dhe “ë”, nenit 24, pikat 1, 2, 3, të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, si dhe nenit 23, pika 12 të “Rregullave të organizimit, funksionimit dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; gjithashtu dhe në zbatim të nenit 11 të “Rregullores për trajtimin e ankesave të paraqitura nga klientët dhe për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve midis të licencuarve, në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror; nenit 18 të “Kontratës për sigurimin e shërbimeve ndihmëse dhe të balancimit të sistemit elektroenergjetik”, bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 16.8.2017, pasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga drejtoritë teknike mbi kërkesën e kompanisë KESH sh.a. për zgjidhjen e mosmarrëveshjes ndërmjet KESH sh.a. dhe OST sh.a., lidhur me përmbushjen e detyrimit të shërbimit publik që rrjedh nga vendimi i ERE-s nr. 194, datë 30.12.2016, “Për miratimin e kërkesës së shoqërisë OST sh.a., lidhur me mbulimin e humbjeve në rrjetin e transmetimit, shërbimet ndihmëse dhe disbalancat”,

konstatoi se:

- Me shkresën nr. 619/1Prot, datë 4.8.2017, kompania KESH sh.a. ka paraqitur pranë ERE-s një kërkesë për zgjidhjen e mosmarrëveshjes të lindur mes saj dhe kompanisë OST sh.a., si rezultat i përmbushje së detyrimit të shërbimit publik që rrjedh nga zbatimi i vendimit të ERE-s nr. 194, datë 30.12.2016, “Për miratimin e kërkesës së shoqërisë OST sh.a., lidhur me mbulimin e humbjeve në rrjetin e transmetimit, shërbimet ndihmëse dhe disbalancat”.

- “Kontrata për sigurimin e shërbimeve ndihmëse të balancimit të sistemit energjetik”, e nënshkruar nga KESH sh.a. dhe OST sh.a., është miratuar me vendimin e ERE-s nr. 79, datë 7.6.2016, mbi miratimin e “Kontratës për sigurimin e shërbimeve ndihmëse dhe të balancimit të sistemit elektroenergjetik për periudhën kohore 1.1.2016 – 30.6.2016” midis OST sh.a. dhe KESH sh.a., aktualisht është në fuqi referuar vendimit nr. 194, datë 30.12.2016 të ERE-s.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Pranimin për shqyrtim nga ERE të ankesës së paraqitur nga kompania KESH sh.a., për zgjidhjen e mosmarrëveshjes ndërmjet KESH sh.a. dhe OST sh.a., lidhur me përmbushjen e detyrimit të shërbimit publik që rrjedh nga vendimi i ERE-s nr. 194, datë 30.12.2016, duke filluar procedurën për zgjidhjen e mosmarrëveshjes konform “Rregullores për trajtimin e ankesave të paraqitura nga klientët dhe për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve midis të licencuarve, në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror”.

2. Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojë palët e interesuara për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti